

VENDIM
Nr. 508, datë 1.8.2012

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 916, DATË 28.12.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË TË
PËRKOSSHME, PËR VITIN 2012, NË NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 pika 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 11 të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 916, datë 28.12.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

1. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2012, në njësitë e qeverisjes qendrore bëhet 640 (gjashtëqind e dyzet) veta. Shtesa prej 1 (një) punonjës është e detajuar sipas lidhjes nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, për zbatimin e këtij vendimi, të përballohen nga shpenzimet korente të njësive të qeverisjes qendrore, të miratuara në buxhetin përkatës të vitit 2012.

3. Ngarkohen ministritë dhe institucionet buxhetore sipas lidhjes nr. 4, të përmendur në pikën 1, të depozitojnë në Ministrinë e Financave detajimin e numrit të punonjësve brenda kriterëve të vendimit nr. 1703, datë 24.12.2008 “Për vendosjen e standardeve të shërbimeve dhe aktiviteteve sezonale/të përkohshme për ministritë dhe institucionet buxhetore”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha